



Prokurimi Publik

Organet qendrore blerëse

PËRMBAJTJA

- [Baza ligjore e OQB-ve](#)
- [Marrëveshjet kuadër](#)
- [Arsyeja e krijimit të OQB-ve](#)
- [Produktet dhe fushat tipike të shërbimeve që mbulohen nga OQB-të](#)
- [Marrëveshjet kuadër që menaxhohen nga disa OQB](#)
- [Çështje kryesore të funksionimit të OQB-ve](#)
- [“Mësimet e nxjerra” kryesore – faktorët e riskut dhe të suksesit](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

Ky Udhëzim ofron një pasqyrë të krijimit dhe të funksionimit të organit qendror blerës (OQB), siç përcaktohet nga Direktiva për Sektorin Publik (Direktiva)¹, dhe është i bazuar në Dokumentin e SIGMA-s nr. 47, *Sistemet e blerjes së përqendruar në Bashkimin Evropian*.² Udhëzimi fokusohet në veçanti në OQB-të që bazojnë veprimtarinë e tyre në dhënie dhe përdorimin e marrëveshjeve kuadër të përqendruara. Direktiva, siç tregohet më poshtë, jep një përkufizim më të gjerë të aktiviteteve të OQB-ve.

Baza ligjore e OQB-ve

Direktiva përmban dispozita të veçanta për OQB-të që e bëjnë qartësisht të mundur që Shtetet Anëtare të miratojnë ose të ruajnë dispozita në lidhje me OQB-të në legjislacionin e tyre kombëtar të prokurimit.³

Përkufizim: OQB-ja është përcaktuar në Direktivë si një autoritet kontraktor që ofron aktivitetet e blerjes së përqendruar dhe, ndoshta, aktivitete ndihmëse blerjeje.

Aktivitetet e blerjes së përqendruar janë aktivitete që realizohen në mënyrë të përhershme, në një nga format e mëposhtme: (1) blerje e furnizimeve dhe/ose shërbimeve të dedikuara për autoritetet kontraktore, ose (2) dhënie e kontratave publike ose lidhja e marrëveshjeve kuadër për punë, furnizime apo shërbime për autoritetet kontraktore.

Aktivitete ndihmëse të blerjes janë aktivitete të përbëra nga ofrimi i mbështetjes për aktivitetet e blerjes, veçanërisht në format e mëposhtme:

- Infrastruktura teknike, duke bërë të mundur që autoritetet kontraktore të japin kontrata publike ose të lidhin marrëveshje kuadër për punë, furnizime ose shërbime;
- Këshilla mbi organizimin ose hartimin e procedurave të prokurimit publik;
- Përgatitja dhe menaxhimi i procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të autoritetit kontraktor në fjalë.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktore të blejnë furnizime dhe/ose shërbime nga një OQB që ofron aktivitetin e blerjes së përqendruar (OQB-ja vepron si një "tregtar i shumicës"). Ato mund të parashikojnë gjithashtu se autoritetet kontraktore blejnë punë, furnizime apo shërbime përmes OQB-ve duke përdorur kontratat e dhëna nga OQB-të, sistemet dinamike të blerjes të operuar nga OQB-të ose marrëveshjet kuadër të lidhura nga OQB-të (OQB-të veprojnë si "ndërmjetës").

Nuk është e detyrueshme për të krijuar OQB-të, por ky është një opsion që i është dhënë Shteteve Anëtare. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që një prokurim i caktuar duhet të kryhet duke iu drejtuar për ndihmë OQB-ve ose një ose më shumë OQB-ve të veçanta. Si pasojë, mund të jetë e detyrueshme në nivel kombëtar që të përdoren shërbimet e OQB-ve për një prokurim.

Është e rëndësishme të theksohet se Direktiva lejon që autoritetet kontraktore të mund t'i japin një kontratë të shërbimit publik një OQB-je për ofrimin e aktiviteteve të përqendruara të blerjes, duke përfshirë aktivitete ndihmëse të blerjes, pa pasur nevojë të zbatohen procedurat e parashikuara në Direktivë.

¹ Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

² SIGMA (2011), *Sistemet e blerjes së përqendruar në Bashkimin Evropian*, Dokumenti i SIGMA-s nr. 47, Botimet e OECD-së, Paris.

³ Direktiva e shërbimeve përmban dispozita të ngjashme: Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

Respektimi i kërkuar i rregullave: Neni 37 (2) i Direktivës është i një rëndësie të veçantë. Ai siguron që autoritetet kontraktore që blejnë punë, furnizime apo shërbime nga një OQB që ofron blerjen e përqendruar vlerësohet se kanë vepruar në përputhje me Direktivën.

Autoriteti kontraktor gjithashtu përmbush detyrimet e tij në përputhje me Direktivën kur blen punë, furnizime apo shërbime duke përdorur kontratat e dhëna nga OQB-ja, sistemet dinamike të blerjes të operuara nga OQB-a, ose nga marrëveshjet kuadër të lidhura nga OQB-ja që ofron blerjen e përqendruar.

Megjithatë, autoriteti kontraktor është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve në përputhje me Direktivën për sa i takon pjesëve të procesit të prokurimit që ai i kryen vetë. Për shembull, kur një marrëveshje kuadër është dhënë nga një OQB në përputhje me dispozitat e Direktivës, atëherë autoritetet kontraktore që blejnë në bazë të kësaj marrëveshjeje kuadër, do të konsiderohen se kanë respektuar dispozitat e Direktivës. Mini-kontratat e mëvonshme⁴ e dhëna nga autoritetet kontraktore duke përdorur marrëveshjen kuadër të dhënë nga OQB-ja do të duhet të jenë në përputhje me dispozitat përkatëse të Direktivës për dhënien e kontratave pasuese të marrëveshjes kuadër, por pa pasur nevojë të kalojnë përmes procesit të plotë të procedurës standarde të dhënies së një kontrate publike. Pa këtë dispozitë, të gjitha mini-kontratat me vlerat mbi pragun monetar të Direktivës mund të jenë vetë subjekt i dhënies së tyre në bazë të Direktivës. Në të njëjtën mënyrë, përgjegjësia e autoritetit kontraktor për përmbushjen e detyrimeve në përputhje me Direktivën mund të mbulojë, për shembull, dhënien e një kontrate në bazë të një sistemi dinamik të blerjes të operuar nga një OQB.

Prokurimi elektronik: Direktiva kërkon që të gjitha procedurat e kryera nga një OQB të realizohen duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit.

Prokurimi që përfshin autoritetet kontraktore nga Shtete të ndryshme Anëtare: Autoritetet kontraktore nga Shtete të ndryshme Anëtare mund të veprojnë së bashku për dhënien e kontratave publike duke përdorur një nga mjetet e përcaktuara në nenin 39 të Direktivës. Kjo dispozitë përfshin opsion për autoritetet kontraktore që ato të përdorin aktivitetet e përqendruara të blerjeve të ofruara nga OQB-të e vendosura në një Shtet tjetër Anëtar. Në qoftë se ndodh kështu, atëherë sigurimi i aktiviteteve të përqendruara të blerjes nga një OQB e vendosur në një Shtet tjetër Anëtar bëhet në përputhje me dispozitat kombëtare të Shtetit Anëtar në të cilin ndodhet OQB-ja. E njëjta dispozitë zbatohet për dhënien e kontratave në bazë të sistemit dinamik të blerjes dhe mini-kontratave në bazë të marrëveshjes kuadër.

Marrëveshjet kuadër

Direktiva e përcakton marrëveshjen kuadër si "një marrëveshje ndërmjet një ose më shumë autoriteteve kontraktore dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është që të krijojë kushtet që rregullojnë kontratat që do të jepen gjatë një periudhe të caktuar, në veçanti në lidhje me çmimin dhe, kur kërkohet, në lidhje me sasinë e parashikuar."

Krijimi dhe funksionimi i një marrëveshje kuadër realizohet në dy hapa: së pari, marrëveshja kuadër jepet për një ose më shumë operatorë ekonomikë. Së dyti, mini-kontratat individuale i jepen një ose më shumë operatorëve ekonomikë. Hapi i dytë ndryshon, në varësi të faktit nëse marrëveshja kuadër ka të bëjë me një furnitor të vetëm apo me furnitorë të shumtë. Për më shumë informacion mbi marrëveshjet kuadër, shikoni Udhëzimin nr. 19 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Marrëveshjet kuadër* dhe Dokumentin e SIGMA-s nr. 47 (shih shënimin fundor 2).

⁴ Procesi i dhënies së kontratave në bazë të një marrëveshjeje kuadër shpesh quhet si "mini-kontratë" ose "dhënie e mini-kontratave" dhe kontratat e dhëna në bazë të marrëveshjes kuadër quhen edhe kontrata të llojit "mini-kontrata".

Duhet të theksohet se dispozitat për marrëveshjet kuadër zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjitha entet prokuroese që janë subjekt i Direktivës, pavarësisht nga dallimet e tyre operationale. OQB-ja, e cila sipas përkufizimit është një autoritet kontraktor që është duke krijuar një marrëveshje kuadër për zbatim të gjerë ndër-sektorial publik duke u mundësuar në këtë mënyrë autoriteteve të tjera kontraktore që të bëjnë mini-kontrata, duhet të aplikojë të njëjtat rregulla dhe procedura si autoritet individual kontraktor, i cili ka për qëllim t'i shërbejë vetëm përdoruesve dhe klientëve të tij të brendshëm.

Arsyeja e krijimit të OQB-ve

Arsyeja për krijimin dhe operimin e një OQB-je duhet të shqyrtohet nga këndvështrime të ndryshme. Palët e interesuara të rëndësishme janë si më poshtë:

- **Konsumatorët** e shërbimeve të OQB-së - autoritetet kontraktore që përdorin marrëveshjen kuadër ose sistemin dinamik të blerjes që operohet nga OQB-ja ose që blejnë furnizime ose shërbime të përfuara nga OQB-ja. Konsumatorët janë të prirur të jenë të interesuar në prokurim efektiv dhe efikas me rezultate të vlerës së parasë.
- **Furnitorët** e punëve, mallrave dhe shërbimeve, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë për OQB-në ose sipas marrëveshjes kuadër ose sistemit dinamik të blerjes - në përgjithësi operatorët ekonomikë të sektorit privat. Furnizuesit janë të prirur të jenë të interesuar në mundësi biznesi dhe në prokurimin efektiv dhe efikas.
- **Pronarët** e OQB-ve - zakonisht ministritë qeveritare, shoqatat e autoriteteve vendore, si dhe organet e tjera publike që përfaqësojnë interesat e tatimpaguesve. Pronarët mund të jenë të interesuar në reduktimin e shpenzimeve publike, në rritjen e vlerës së parasë, dhe realizimin e qëllimeve të caktuara të politikave të rëndësishme, të tilla si ato që lidhen me çështjet mjedisore ose sociale ose me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të).

Arsyeja kryesore për krijimin e OQB-së përshkruhet shpesh në kushtet e mëposhtme:

- “Vëllimet e mëdha të prokurimit japin çmime më të mira.”

Në bazë të kushteve të duhura, prokurimi i përqendruar i bazuar në një agregim të nevojave blerëse të gjithë konsumatorëve të OQB-së ofron mundësi shumë interesante biznesit për sektorin privat. Vëllimet e mëdha të prokurimit zakonisht çojnë në konkurrencë në rritje në treg duke ndikuar në çmimet dhe kushtet e tjera në mënyra që janë të favorshme për blerësin e autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor individual rrallë do të ketë një vëllim të madhe prokurimi të mjaftueshëm për të nxjerrë çmimet që janë të krahasueshme me ato që merren në një situatë kur është bërë një grumbullim i nevojave ndërmjet disa autoriteteve kontraktore. Volumet potencialisht të mëdha të shitjes që mund të priten në bazë të prokurimit të përqendruar nënkuptojnë se operatorët ekonomikë mund të shfrytëzojnë ekonominë e shkallës.

Për sistemin e përqendruar të blerjes të bazuar në dhënien dhe menaxhimin e marrëveshjeve kuadër, faktori i agregimit apo i grumbullimit dhe ndikimi i tij tek çmimet duhet të vlerësohet në lidhje me llojin dhe objektin e marrëveshjes kuadër që do të jepet.

- “ulen kostot e transaksionit.”

Nga këndvështrimi i autoriteteve kontraktore, procesi i plotë konkurrues i prokurimit, i krahasuar me ushtrimin e thjeshtë të mini-kontratave, është i lidhur zakonisht me kosto substanciale të transaksioneve për sa i takon kohës dhe shpenzimeve që lidhen me menaxhimin e procesit të prokurimit, nga e faza e parë e përcaktimit të nevojave deri në fazën përfundimtare të mbylljes së dosjes. Operatorët ekonomikë kanë kosto të mëdha transaksionesh kur marrin pjesë në një tender. Me marrëveshjet kuadër të

përqendruara, si autoritetet kontraktore ashtu edhe operatorët ekonomikë mund të presin një reduktim të ndjeshëm të këtyre kostove. Për më tepër, reduktimi i kostove të transaksioneve të kryera nga autoritetet dhe operatorët ekonomikë çon në lirim të burimeve siç janë ato të personelit dhe kohës kontraktore që mund të përdoren për funksione të tjera më të rëndësishme.

Megjithatë, ashtu si në rastin e ndikimit tek çmimet, efekti i agregimit të kostove të transaksioneve të shkaktuara si nga autoritetet kontraktore, ashtu edhe sektori privat nuk mund të përgjithësohet, por duhet të llogaritet në lidhje me llojin e marrëveshjes kuadër të përdorur. Mini-kontrata e bazuar në marrëveshjen kuadër me një furnizues nuk do të sjellë ndonjë kosto tenderimi (vetëm kostot e transaksionit për bërjen e porosive), ndërsa marrëveshja kuadër me shumë furnitorë që përfshin mini-konkurrimin, do të sillte shpenzime tenderimi për autoritetin kontraktor si dhe për operatorët ekonomikë.

- “ndodhin përfitime të tjera të një natyre të konsiderueshme.”

Sistemet e blerjes së përqendruar mund të ofrojnë përparësi që nuk mund të shprehen drejtpërdrejt në aspektin ekonomik.

Argumentet në favor të marrëveshjeve të blerjeve të përqendruara përfshijnë:

- Rritjen e efikasitetit administrativ: zgjidhjet e përqendruara dhe të bashkërenduara të ofruara nga OQB-të mund të ndihmojnë në sigurimin e standardizimit të kërkuar ose në rritjen e efikasitetit administrativ brenda administratës publike, për shembull në fushën e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe aplikacioneve të softuerëve.
- Ekspertizën dhe kapacitetin: OQB-të mund të sigurojnë ekspertizën dhe kapacitetet që shumë autoritete kontraktore mund të mos i kenë, për shembull, njohja e një tregu të caktuar apo kapaciteti për të përgatitur dhe kryer tendera kompleks në fushat që kërkojnë produkte të veçanta.
- Sigurinë: blerja e përqendruar profesionale u jep siguri autoriteteve kontraktore në shumë aspekte të rëndësishme - ligjore, teknike, ekonomike dhe kontraktuale - duke zvogëluar risqet që do të ishin krijuar në rrethana të tjera për autoritetin kontraktor. Këto risqe mund të përfshinin riskun e ankesave, cilësinë e dobët ose të pamjaftueshme të prodhimeve, dështimin e furnitorëve, dhe kushtet jo të përshtatshme të kontratës.
- Thjeshtësinë: mini-kontratat i japin entit prokurues dhe departamenteve të përdoruesve të tij mundësinë e kontratës, madje edhe pa ndonjë përgatitje profesionale për prokurimin, me operatorët ekonomikë që janë palë në marrëveshjen kuadër për blerjen e punëve, mallrave dhe shërbimeve.
- Arritja e qëllimeve të politikës: Qeveritë mund t'i përdorin OQB-të si instrumente për realizimin e synimeve të politikave në sektorë të veçantë, të tillë si promovimi i prokurimit të gjelbër, inovacionet dhe pjesëmarrjen e NVM-ve në tenderat e sektorit publik.

Argumentet kundër organizimeve të blerjes së përqendruar përfshijnë:

- **Përqendrimi i tregut:** Aktivitetet e OQB-ve mund të krijojnë rrezikun e koncentrimin të tregut dhe zhvillimin e strukturave monopoliste. Vëllimet e mëdha, të cilat përfshihen shpesh në prokurimin e përqendruar, priren të favorizojnë operatorët e mëdhenj ekonomikë dhe jo operatorët e rinj ekonomikë të vegjël.
- **Mundësi të reduktuara për NVM-të:** OQB-të shpesh bëjnë tendera me vlerë të lartë apo kontrata të mëdha. Ndodh shpesh që NVM-të nuk do të jetë në gjendje të marrin

pjesë në cilësinë e tyre, pasi ndoshta nuk janë në gjendje që të përmbushin kriteret e kualifikimit ose të konkurrojnë me operatorët e mëdhenj ekonomikë. Në vend të kësaj, NVM-të mund të veprojnë si nën-kontraktorë ose të marrin pjesë në konsorciume. Interesi më i madh i NVM-ve është më i mundshëm kur blerësi ka organizuar lote të një natyre dhe madhësie të tillë që NVM-të do të jenë në gjendje që të marrin pjesë si ofertues në cilësinë e tyre.

- **Mungesa e reagimit ndaj ndryshimeve të tregut:** për shkak të kohëzgjatjes së tyre të gjatë (zakonisht dy deri në katër vjet), marrëveshjet kuadër mund të jenë relativisht jo reaguese ndaj ndryshimeve të vazhdueshme në treg, nëse ato janë të hartuara në mënyrë korrekte. Hartimi i pasaktë i kontratës publike kuadër mund të çojë potencialisht në zhvillime të rëndësishme të çmimeve të tregut dhe në lënien pas dore të teknologjisë. Prandaj është e rëndësishme që kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër të vendosur realisht dhe që të ruhet konkurrenca nëpërmjet përdorimit të mini-tenderave.
- **Uniformiteti:** Uniformiteti i shumë marrëveshjeve kuadër dhe shkalla e standardizimit përbëjnë një tjetër shqetësim. Marrëveshjet kuadër nganjëherë kanë tendencë që të ofrojnë një qasje që është shumë e kufizuar, në veçanti në lidhje me aspektet teknike. Ky uniformitet e bën të vështirë që autoritetet kontraktore të përmbushin plotësisht objektivat e tyre të prokurimit.

Produktet dhe fushat tipike të shërbimeve që mbulojnë nga OQB-të

Punët, furnizimet dhe shërbimet e mbuluara nga marrëveshjet kuadër të dhëna nga OQB-të në përgjithësi duhet të jetë me interes të përbashkët dhe të blihen nga e gjithë administrata publike. Gama e artikujve të mbuluar nga operacionet e OQB-ve zakonisht përfshijnë furnizimet dhe shërbimet e mëposhtme (kontratat e punëve jepen më rrallë nga OQB-të):

- Produktet dhe shërbimet e TIK-ut (kompjuterat, fotokopjues, printera, servera, sofuerë);
- Produktet e telekomunikacionit (rrjete, telefona celular, telefonat fiks, shkëmbimet telefonike);
- Mobilie zyre;
- Shërbimet e udhëtimit;
- Pajisje zyre dhe kancelari;
- Shërbimet e automjeteve dhe të transportit;
- Karburantin (për ngrohje dhe transport) dhe energjinë elektrike;
- Ushqimin (materialet ushqimore, latat e vakteve);
- Shërbimet e zhvillimit të burimeve organizative dhe njerëzore.

Për më shumë detaje mbi këtë objekt tipik të marrëveshjes kuadër publike, shih Dokumentin nr. 47 të SIGMA-s (shënimi fundor 2).

Për sa i takon blerjes së volumeve, fusha më e madhe e produktit në përgjithësi është ajo e produkteve të TIK-ut. Edhe pse shumë prej produkteve dhe shërbimeve mund të konsiderohen si relativisht të thjeshta dhe të standardizuara nga pikëpamja teknike, ka edhe zona të kompleksitetit të lartë teknik dhe tregtar (të tilla si sistemet e avancuara të TI-së) që mund të jenë nën përgjegjësinë e një OQB-je. Në fakt, OQB-ja mund të ofrojë produkte të standardizuara dhe shërbime të një rëndësie jo-strategjike, si dhe produkte dhe shërbime të një rëndësie të madhe strategjike. Në rastin e fundit, marrëveshja e përqendruar drejtohet shpesh nga objektivat e pronarit për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin administrativ

brenda sektorit publik në tërësi, duke siguruar ndërveprimin dhe standardizimin e sistemeve administrative të përdorura nga autoritetet kontraktore.

Marrëveshjet kuadër që menaxhohen nga disa OQB

Organi Qendror i Blerjes	Produktet dhe shërbimet
SKI, Danimarkë	Teknologjia e informacionit, mobiljet, pajisje e zyrës, energjia, automobilat, syzet, materialet ushqimore, pajisjet e qendrës së kateringut, pajisjet elektrike, materialet e ndërtimit, veglat, lëndët drusore, rrobat e punës, shërbimet e pastrimit, pajisjet kërkimore dhe laboratorike, stafi i përkohshëm, inxhinierët e konsultimit, dhe konsulenca e menaxhimit.
Hansel, Finlandë	70 marrëveshjet kuadër që mbulojnë kontratat e prokurimit të TIK-ut (TIK harduerë, softuerë dhe shërbime), prokurimin e shërbimeve administrative (administrimin financiar, zhvillimin organizativ dhe të burimeve njerëzore, menaxhimin e udhëtimit dhe konferencat), prokurimin e materialeve dhe shërbimeve teknike (materiale shërbime të objektit, shërbimet e automjeteve dhe të transportit, shërbimet e furnizimit të zyrave dhe të energjisë).
UGAP, Francë	Produktet dhe shërbimet ndahen në gjashtë grupe: pajisjet TI, pajisjet mjekësore, mobiljet, automjetet, maskat respiratore, dhe shërbimet.
KSzF, Hungari	Komunikimi i informacionit, telekomunikacioni, pajisjet e zyrës, shërbimet e qeverisjes elektronike, mobiljet e zyrës, letra dhe kancelaritë, automjetet, karburanti, furnizimet mjekësore dhe shërbimet e udhëtimit.
Consip, Itali	Kujdesi shëndetësor (p.sh. ambulanca, pajisje diagnostikuese, shërbimet për menaxhimin e pajisjeve të kujdesit shëndetësor); karburanti (për ngrohje dhe transport) dhe energjia elektrike; mallrat/pajisjet e zyrave (printer, fotokopjues, kompjutera, servera, softuerë); transporti (blerja e makinave dhe marrja me qira); menaxhimi i objekteve (për zyra, spitale); telekomunikacioni (rrjetet, telefona celular, telefonat fiks, shkëmbimet telefonike); mobiljet (për zyra, shkolla, universitete); shërbimet e sigurimeve dhe financiare (kartat e kreditit); ushqimi (mallrat ushqimore, latat e vakteve).

Burimi: Dokumenti nr. 47 i SIGMA-s, Sistemet e Organeve Qendrore të Blerjes në Bashkimin Evropian (Shënim fundor 2).

Çështje kryesore të funksionimit të OQB-ve

A duhet të jetë i detyrueshëm për autoritetet kontraktore përdorimi i shërbimeve të OQB-ve? Në disa vende, qeveritë e kanë bërë të detyrueshme që autoritetet kontraktore të blejnë punë, furnizime apo shërbime të caktuara nëpërmjet ose nga një OQB. Në vende të tjera, është në dorë të autoriteteve kontraktore të përdorin cilindo burim që u garanton "vlerën e parasë" më të mirë.

Ithtarët e sistemit sipas të cilit autoritetet kontraktore do të detyrohen, në parim, që të përdorin shërbimet e OQB-ve argumentojnë se kjo masë do të siguronte përdorimin me kosto-efektivitet të burimeve publike dhe do të rriste standardizimin në mesin e autoriteteve kontraktore. Kritikët argumentojnë se një kërkesë e tillë do të dobësonte nxitje e OQB-ve që të ishin miqësore me përdoruesit dhe do të krijonte rrezikun e sjelljes monopoliste.

Është argumentuar se një nga përfitimet e pasjes së një sistemi vullnetar është se ai siguron nxitjen e OQB-ve që të ofrojnë marrëveshje kuadër të favorshme, si dhe shërbime të tjera për klientët e tyre në kushte konkurruese. Nëse OQB-të nuk e bëjnë këtë, atëherë nuk do të ketë kërkesa për shërbimet e tyre dhe ekzistenca e tyre do të jetë në rrezik. Përfitimi i një sistemi

vullnetar është se ai ekspozon OQB-në ndaj një forme të konkurrencës, e cila e stimulon atë që të ofrojë produkte tërheqëse, duke krijuar vlerën më të madhe të parasë.

Çfarë forme organizative merr një OQB? Forma më e zakonshme organizative e një OQB-je duket se është ajo e shoqërisë jofitimprurëse të kufizuar, edhe pse është përdorur modeli i një agjencie qeveritare. Për më shumë informacion mbi llojet e formave organizative të OQB-ve në vendet e anketuara shih Dokumentin nr. 47 të SIGMA-s (shih shënimin 2).

Si duhet të financohen operacionet e një OQB-je? Shumë OQB financohen me pagesat e shërbimeve. Janë përdorur dy variante të ndryshme: ose autoritetet kontraktore paguajnë një tarifë kur bëhen mini-kontratave ose operatorët ekonomikë paguajnë tarifën kur ata faturojnë nëpër marrëveshje kuadër. Një model alternativ i financimit është ai i financimit të OQB-ve direkt nga fondet e qeverisë.

Cila është rëndësia e marrëdhënieve të mira ndërmjet konsumatorëve dhe furnitorëve? Objektivi kryesor i një OQB-së është që të sigurojë marrëveshje kuadër tërheqëse dhe të realizueshme, të cilat kërkojnë përfshirjen e fortë të konsumatorëve në të gjithë procesin e prokurimit: përcaktimi i përshtatshmërisë së një produkti të veçantë ose i fushë së shërbimit për blerjen e bazuar në marrëveshjen kuadër; hartimi i specifikimeve teknike, zgjedhja e ofertës dhe kriteret e vlerësimit; zgjedhja e llojit të marrëveshjes kuadër dhe sistemit të mini-kontratave; dhe dhënia e marrëveshjes kuadër.

Realizmi efektiv i funksioneve kryesore të OQB-së bazohet në kapacitetin dhe aftësinë e saj për "të kuptuar dhe menaxhuar" tregun e furnizimit me efikasitet, gjë e cila kërkon që OQB-ja t'i njohë furnizuesit kryesorë të një produkti specifik apo të një segmenti shërbimi të tregut, si dhe madhësinë e tyre dhe praninë në treg. Informacioni paraprak dhe dialogu me operatorët ekonomikë në një fazë të hershme të procesit të prokurimit, kur kryhet në mënyrë transparente dhe në përputhje me rregullat e zbatueshme të prokurimit, janë të vlefshme për përcaktimin e opsioneve të ndryshme për hartimin më të mirë të strategjive të kontraktimit dhe prokurimit për marrëveshjet kuadër dhe sistemet bashkangjitur të mini-kontratave.

Çfarë lloje marrëveshjesh kuadër duhet të përdoren? Direktiva u lejon OQB-ve liri të konsiderueshme sa i përket llojit të marrëveshjes dhe procedurat që do të përdorin. OQB-të përfitojnë nga kjo liri, dhe si rezultat janë përdorur si marrëveshjet kuadër me një furnitor të vetëm ashtu edhe marrëveshjet kuadër me shumë furnitorë, si dhe procedurat e ndryshme të mini-kontratave.

Një përparësi e kontratës kuadër publike me një furnitor është se dhënia e një kontrate të tillë ka të ngjarë të jetë shumë e vlefshme për operatorin ekonomik të zgjedhur. Kjo përparësi ka të bëjë me natyrën "fituesi i merr të gjitha" të një kontrate të tillë.

Marrëveshjet kuadër kanë avantazhin e sigurimit të më shumë burimeve të furnizimit se sa marrëveshjet me një furnitor të vetëm. Një tjetër avantazh është se rreziku i një përqendrimi të tregut në mënyrë të njëpasnjëshme është më i vogël. Një dëm i mundshëm i një marrëveshje me shumë furnitorë është se në shumicën e të drejtave kombëtare operatorët ekonomikë nuk kanë garanci se mund të shesin gjë sipas marrëveshjeve të tyre kuadër.

Opsioni ku autoritetet kontraktore bëjnë mini-kontrata nëpërmjet një mini-konkurrimi ka avantazhin e prezantimit të një lloji konkurrence të vazhdueshme në mes të operatorëve ekonomikë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër. Nga ana tjetër, opsioni i mini-konkurimit mund të përfshijë kosto të konsiderueshme transaksioni.

Si duhet të matet performanca e një OQB-je? Në përgjithësi, është e vështirë për të llogaritur kursimet që janë krijuar përmes prokurimit të përqendruar. Arsyeja themelore për këtë është pamundësia për të vëzhguar rezultatin kundrejt prokurimit të përqendruar të furnizimeve ose shërbimeve dhe çmimet e ndryshme si dhe kushtet e tjera të krijuara nga një metodë alternative e prokurimit. Pra, duhet të krijohet një rezultat alternativ në një farë mënyre.

Disa OQB kanë zhvilluar në bashkëpunim me universitetet metoda për matjen e performancës. Këto vlerësime japë informacion të vlefshëm në lidhje me performancën, veçanërisht në qoftë se ato organizohen në mënyrë periodike me qëllim që të mund të shihen tendencat dhe modelet me kalimin e kohës. Gjithashtu, këto vlerësime kanë funksionin e rëndësishëm të vënies nën një presion të caktuar të OQB-ve, të cilat janë të vetëdijshme se puna e tyre është nën vëzhgim. Për më shumë informacion në lidhje me matjen e performancës, shih Udhëzimin nr. 21 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Matja e performancës*.

“Mësimet e nxjerra” kryesore – faktorët e riskut dhe të suksesit

Për të ngritur dhe zbatuar me sukses një sistem blerje të përqendruar që është modern dhe krijon vlerë duhet të kuptohen dhe të trajtohen disa sfida – faktorë të riskut dhe të suksesit. Nëse ato nuk trajtohen, atëherë sukcesi i OQB-së mund të rrezikohet.

Sistemet e blerjes së përqendruar mund të organizohen dhe menaxhohen në mënyra të ndryshme - nuk ka një model të vetëm të mirë: blerja e përqendruar kryhet në mënyra të ndryshme, dhe dallimet mund të ekzistojnë në lidhje me sa më poshtë vijon:

- Statusin ligjor të OQB-ve dhe sektorët/nivelet e administratës publike që ato mbulojnë;
- Mënyrën në të cilën janë dhënë nga pronari apo pronarët mandatet e OQB-ve;
- Llojet e marrëveshjeve kuadër dhe sistemet e mini-kontratave të përdorura;
- Organizimi dhe financimi i OQB-ve.

Ndjeshmëria ndaj nevojave të aktorëve kryesorë: Sukcesi i një OQB-je do të varet nga shkalla në të cilën mund të forcohet dhe të ruhet besimi në marrëdhëniet e saj me grupet e mëdha të interesit - pronarët, autoritetet kontraktore dhe furnitorët.

Marrëveshjet kuadër "konkurrese" me sisteme miqësore për përdoruesit dhe të mini-kontratave me risk të ulët: sukcesi i një OQB-je varet shumë nga aftësia e saj për të ofruar marrëveshje kuadër që janë tërheqëse nga pikëpamja teknike dhe komerciale për një pjesë të madhe të "klientëve" të mundshëm në sektorin publik të cilit i shërben OQB-ja. Kjo aftësi është vendimtare për një OQB në një mjedis vullnetar, ndërkohë që është pothuajse po aq e rëndësishme për një OQB që operon në një situatë të detyrueshme.

Identifikimi i përshtatshëm i objektit dhe i vlerës së kontratës: OQB-të kanë vënë në funksion mekanizma për identifikimin jo vetëm të punëve, mallrave dhe shërbimeve të blera përmes prokurimit të përqendruar, por edhe të vlerës së këtyre kontratave, zakonisht të bazuar në një analizë të thellë të kërkesës dhe ofertës ose të bazuar në studime të fizibilitetit. Identifikimi i objektit dhe i vlerës së kontratave që do të jepen bazuar në një marrëveshje kuadër, u jep ofertuesve të mundshëm informacionin që duhet për të vendosur nëse ata do të marrin pjesë apo jo. Në mënyrë të ngjashme, lloji i marrëveshjes kuadër (me një furnitor të vetëm apo me shumë furnitorë) do të ndryshojë sipas këndvështrimit të ofertuesve, shkallës potenciale të suksesit të pjesëmarrjes dhe, në fakt, kjo do të ndryshojë objektin dhe vlerën e marrëveshjes. Zgjedhja e mekanizmave të mini-kontratave është gjithashtu një faktor që duhet të merret parasysh në lidhje të qenit tërheqëse të marrëveshjes kuadër.

Një organizatë efikase me staf kompetent: Projektimi i strukturës së OQB-së është jetik për suksesin e saj dhe duhet të pasqyrojë karakteristikat e veçanta të punës së saj. Funksionet e saj kryesore zakonisht përqendrohen rreth marrëdhënieve të tregut dhe të konsumatorëve, menaxhimit të produktit, prokurimit dhe menaxhimit të kontratave, së bashku me funksionet kryesore mbështetëse, të tilla si TIK-u, shërbimet ligjore dhe administrimi, duke përfshirë kontabilitetin.

Mosmenaxhimi në mënyrë efektive i riskut ligjor: disa OQB kanë dëshmuar një rritje të numrit të ankesave që kanë të bëjnë jo vetëm me tenderat për dhënien e marrëveshjeve kuadër por

edhe me procedimet gjatë fazës së mini-kontratave, gjë e cila komplikon edhe më tepër pozicionin e OQB-ve. Ankesat lidhur me marrëveshjet me shumë furnitorë nënkupton transferimin e riskut nga OQB-ja tek autoritetet kontraktore, gjë e cila mund të krijojë një situatë të pasigurisë juridike.

Mungesa e fokusit: Një rrezik tjetër është se OQB-ja do të fillojë që ta humbasë fokusin dhe të përpiqet për të zgjeruar kufijtë e operacioneve të saj në fushat ku ajo ose nuk ka një avantazh konkurrues, ose nuk është në gjendje për t'iu përgjigjur siç duhet nevojave të autoriteteve kontraktore, duke u ofruar autoriteteve kontraktore shërbime ose marrëveshjet kuadër që nuk janë potencialisht tërheqëse.

Informacion i mëtejshëm

Botime

SIGMA (2015), *Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik – Moduli D1*, Botimet e OECD-së, Paris. <http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

SIGMA (2007), *Strukturat Qendrore të Prokurimit Publik dhe Kapacitetet në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian*, Dokumenti nr. 40 i SIGMA-s, Botimet e OECD-së, Paris,

http://www.sigmaweb.org/publications/Alb_SP40_07.pdf

Udhëzimet e prokurimit publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

SIGMA (2016), *Marrëveshjet kuadër*, Udhëzimi 19, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Matja e performancës*, Udhëzimi 21, Botimet e OECD-së, Paris.